

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 16 DHJETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Konform dispozitave kushtetuese dhe parashikimeve të Rregullores së funksionimit të organit tonë parlamentar, depozitova në datën 9 nëntor kërkesën për interpelancë me Kryeministrin, zotin Edi Rama, për politikën e qeverisë në lidhje me respektimin e të drejtave të minoriteteve, me nivelin e përmbushjes së standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në vendin tonë dhe me objektivat në kuadrin e negocimit me Bashkimin Europian. Pse e kërkoja me Kryeministrin interpelancën? Jo se nuk kam respekt maksimal, të cilin e shpreh edhe një herë, si për ministren për Marrëdhëniet me Parlamentin, zonjën Spiropali, ashtu edhe për cilindo ministër dhe cilendo ministre apo çdo koleg, sepse debati është gjithmonë i frytshëm, por, përveç faktit se nuk respektohet afati kohor i interpelancës, brenda 3 javëve, sot në mëngjes njoftohem se Kryeministri nuk paska denjuar të diskutojmë në lidhje me këtë çështje dhe e ka deleguar.

Natyrisht, ka dy mënyra sesi mund ta trajtoj këtë: e para është mënyra cinike, dhe besoj se e kam të plotë mundësinë që ta bëj, por jo dëshirën, dhe, mënyra e dytë është konstruktive, ashtu siç duhet të jemi të gjithë me njëri-tjetrin, me institucionet, me vlerat dhe me parimet e një sistemi të mirëqenë demokratik. Një profesor i shquar i London School of Economics, gjerman me origjinë, thotë se respektimi i të drejtave të minoriteteve është litmus test, është testi i letërlakmuesit në lidhje me funksionimin e shtetit të së drejtës dhe respektimit të lirisë. Qëndrimi i sotëm i Kryeministrit Rama dëshmon se për të respektimi i të drejtave të minoriteteve dhe i lirisë të tyre nuk ekziston në agjendën e prioritetëve të tij, por, për fatin tonë të mirë, ekziston në agjendën e Bashkimit Europian. Përdje ne nuk morëm datë për Konferencën e Parë Ndërqeveritare, që uroj ta marrim së shpejti dhe të kontribuojmë të gjithë që ta marrim së shpejti, por patëm konkluzione të qarta, ku midis tyre ishin edhe ato që kanë të bëjnë me të drejtat e pjesëtarëve të minoriteteve, me aktet nënligjore që duhet të dalin, me implementimin e këtyre akteve nënligjore, me regjistrimin e ardhshëm të popullsisë që duhet të zhvillohet konform standardeve, i cili është zhvilluar dhe zhvillohet në të gjitha vendet demokratike, si dhe me çështjen e pronave dhe me respektimin e kësaj të drejte të shenjtë.

Pra, kuadri i të drejtave të minoriteteve nis që nga ministrja në Marrëdhëniet me Parlamentin, te ministri i Drejtësisë, te ministri i Brendshëm, te Komiteti i Minoriteteve, i cili varet direkt nga Kryeministra, dhe te çdo ministër tjetër. Ky debat nuk mund të bëhet i fragmentarizuar, por mund të bëhet vetëm dhe vetëm me atë të cilit i jam drejtuar, me Kryeministrin, zotin Rama. Rrjedhimisht, me keqardhje, zonja Kryetare, nuk e pranoj zhvillimin e kësaj interpelance. Nëse ju keni mirëkuptimin, zhvendoseni vetë në një datë tjetër të përshtatshme për Kryeministrin, në qoftë se nuk do ta bëni ju, atëherë, do të detyrohemi ta riparoqes kërkesën, por duhet ta dini se ky është qëndrim abuziv dhe dëshmi e vullnetëve negative. Ju faleminderit!